



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:064114
Datë: 10.03.2026
Numri i dokumentit: 08600008

K.Dh.Shk.II.nr.942/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit “KOSST” Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A., me NUI:81188887, me seli në Prishtinë, rr. “Isa Boletini”, kundër debitorit KESCO SH.A., me NUI:81188887, me seli në Prishtinë, rr. “Bulevardi Bill Clinton”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2142/22 të datës 18.04.2025 me datë 10.03.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e debitorit KESCO SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2142/22 të datës 18.04.2025, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2142/22 të datës 18.04.2025, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit KESCO SH.A., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përbarimor P.nr.133/22, të datës 22.08.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, sa i përket borxhit kryesor prej 2,034,270.09 € dhe procedura për këtë pjesë të përbarimit përfundon. Në pikën II, të dispozitivit, ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përbarimor P.nr.133/22, të datës 22.08.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, sa i përket kamatës ligjore prej 4.5% mbi borxhin kryesor si në pikën I të dispozitivit si dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2142/22 të datës 18.04.2025, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit dhe të ndryshoj pjesën sa i përket kamatë vonesës të aktvendimi e atakuar, të refuzohet urdhëri përbarimor P.nr.133/22, të datës 22.08.2022.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e debitori është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “KOSST” Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A., me datën 22.08.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit KESCO SH.A., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 089 e datës 13.04.2022 dhe Faturës Nr.0106 e datës 13.04.2022, për shumën e borxhit prej 2,034,270.09 €, me kamatë sipas ligjore vjetore prej 4.5% , nga data e arritshmërisë së faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.133/22, të datës 22.08.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 089 e datës 13.04.2022 dhe Faturës Nr.0106 e datës 13.04.2022, për shumën e borxhit prej 2,034,270.09 €, me kamatë sipas ligjore vjetore prej 4.5% , nga data e arritshmërisë së faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2142/22 të datës 18.04.2025, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit KESCO SH.A., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.133/22, të datës 22.08.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, sa i përket borxhit kryesor prej 2,034,270.09 € dhe procedura për këtë pjesë të përmbartimit përfundon. Në pikën II, të dispozitivit, ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.133/22, të datës 22.08.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, sa i përket kamatës ligjore prej 4.5% mbi borxhin kryesor si në pikën I të dispozitivit si dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata pas shqyrtimi të pretendimeve të palëve ndërgjyqësve dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka theksuar se në rastin konkret, gjeti se Urdhri Përmbartimor P.nr.493/25, të datës 05.06.2025, duhet të anulohet

pjesërisht dhe atë në pikën I të dispozitivit duhet të anulohet urdhëri përmbartimor sa i përket kërkesës së kreditorit në shumën prej 2,034,270.09 € sipas urdhëri të lëshuar ndërsa gjykata ka vërejtur se shuma në tërësi në bazë të Faturave nr.089 e datës 13.04.2022 dhe nr.0106 e datës 13.04.2022 është paguar nga ana e debitorit, për këtë arsye gjykata ka gjetur se kreditorit duhet pjesërisht kërkesën t'ia përbaroj, pra për shumën 2,034,270.09 € dhe këto fatura janë bërë pa efekt juridik për shkakë pagesës së debitorit. Përmbartimi mund të fillohet në bazë të faturave si dokument i besueshëm dhe se për ta caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore, pra në rastin konkret faturat lëndore është përmbushur dhe ka humbur efektin juridik duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par. 1.2 të LPP-së më të cilën përcaktohet se *“dokumenti bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhëri përmbartimor është prishur, anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar në një mënyrë tjetër gjegjësisht ka humbur efektin e tij osë është pa efekt”*, gjithashtu bazuar në nenin 66.4 të LPP-së, për përmbushjes së kredisë së kreditori nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore, prandaj gjykata e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe për këtë arsye ka anuluar urdhërin përmbartimore në lidhje me këtë shumë. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.493/25, të datës 05.06.2025, sa i përket kamatës për vonesë vjetore në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor, për faktin se në bazë të parashtrës të datës 16.04.2025, kreditori ka deklaruar për përmbushje të kryegjës dhe ka kërkuar vetëm kamatëvonesë dhe shpenzimet e procedurës. Prandaj meqenëse debitori ka rënë në vones për përmbushjen e borxhit kryesor në mbështetje të nenit 382 par.1 të LMD-së me të cilën përcaktohet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.”*, në lidhje me nenin 383 të LMD-së me të cilin parashihet se *“Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më i lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj”*, pra gjykata ka vendosur që të mbetet urdhëri përmbartimore sa i përket kamatës në vonesë e cila kamatë ka qenë e kontraktuar mes palëve. Gjukata ka vendosur sa i përket shpenzimeve duke lënë në fuqi urdhërin përmbartimor duke u bazuar në nenin 13 par. 4 të LPP-së të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-118 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore i cili parasheh *“nenin 13 ligjit bazik, ndryshohet si vijon : Përveç tarifës së efikasitetit të përmbartimit e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbartuesit privat dhe kreditorit tarifave të tjera paraprakisht paguhen nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës ato i ngarkohen debitorit.*

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjukata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjukata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me

rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar si në pikën I të dispozitivit, ku pra sipas Faturës Nr. 089 e datës 13.04.2022 dhe Faturës Nr.0106 e datës 13.04.2022 kreditori ka kërkuar shumën 2,034,270.09 € , ndërsa gjykata shkallës së parë me të drejtë, vërejtur se është paguar kjo shumë nga ana e debitorit, për këtë arsye gjykata ka gjetur se kreditorit duhet pjesërisht kërkesën t’ia përbaroj, pra për shumën 2,034,270.09 € dhe këto fatura janë bërë pa efekt juridik për shkakë pagesës së debitorit. Përbarimi mund të fillohet në bazë të faturave si dokument i besueshëm dhe se për ta caktuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore, pra në rastin konkret faturat lëndore është përmbushur dhe ka humbur efektin juridik duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par. 1.2 të LPP-së më të cilën përcaktohet se *“dokumenti bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhëri përbarimor është prishur, anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar në një mënyrë tjetër gjegjësisht ka humbur efektin e tij ose është pa efekt”*, gjithashtu bazuar në nenin 66.4 të LPP-së, për përmbushjes së kredisë së kreditori nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore, prandaj gjykata e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe për këtë arsye ka anuluar urdhërin përbarimor në lidhje me këtë shumë. Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në pikën, II të dispozitivit duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.493/25, të datës 05.06.2025, sa i përket kamatës për vonesë vjetore në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor, për faktin se në bazë të parashtrësës të datës 16.04.2025, kreditori ka deklaruar për përmbushje të kryegjës dhe ka kërkuar vetëm kamatëvonesë dhe shpenzimet e procedurës. Prandaj meqenëse debitori ka rënë në vones për përmbushjen e borxhit kryesor në mbështetje të nenit 382 par.1 të LMD-së me të cilën përcaktohet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.”*, në lidhje me neni 383 të LMD-së me të cilin parashihet se *“Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më i lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj”*, pra gjykata ka vendosur që të mbetet urdhëri përbarimor sa i përket kamatës në vonesë e cila kamatë ka qenë e kontraktuar mes palëve. Gjukata drejt ka vendosur sa i përket shpenzimeve duke lënë në fuqi urdhërin përbarimor duke u bazuar në nenin 13 par. 4 të LPP-së të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-118 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën përbarimore i cili parasheh *“ nenin 13 ligjit bazik, ndryshohet si vijon : Përveç tarifës së efikasitetit të përbarimit e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përbaruesit privat dhe kreditorit tarifa të tjera paraparakisht paguhen nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës ato i ngarkohen debitorit.*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokumente i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përbarimore, respektivisht është lejuar përbarimi janë përmbushur dhe kanë humbur efektin e tyre juridik. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat janë të përmbushura nga debitori. Sa i përket kamatës që është parapare sipas marrëveshjes mes kreditorit dhe debitori qëndron pasi që është pranuar nga dy palët, për detyrimin që rrjedh prej tyre.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me vërtetimin të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështrohet sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.942/25 dt. 10.03.2026

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi

